



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:025453

Datë: 14.04.2021

Numri i dokumentit: 01688159

P. nr.100/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Antigona Zahiti, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: V.P., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar. 3.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.38/2021 (2021:0001649), të datës 10.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 23.03.2021, në prezencën e Prokurores të Shtetit Jelena Marjanovic dhe të akuzuarit V.P., të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 14.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.P., nga i ati M., e ëma V., e vajzërisë B., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku dhe jeton, punon si mirmbajtës në spital, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

ËSHTË FAJTOR

sepse,

Me datën 20.12.2020, rreth orës 20:20 minuta, në Mitrovicë, në gjendje të vetëdijshme, në shtëpinë e tij familjare i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore te dëmtuarës-bashkëshortes së tij M.P., në atë mënyrë që në gjendje të dehur ka filluar verbalisht ta ofendoj bashkëshorten e tij duke e thirrur me emra të papërshtatshëm në prezencën e fëmijut të tij të mitur, pasi që fizikisht e ka sulmuar dhe e ka goditur në pjesën e krahut të majtë, duke i shkaktuar trauma sipërfaqësore të krahorit dhe parakraut të dorës së majtë, lëndime këto të karakterizuara si lëndimeve të lehta trupore.

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar. 3.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 50, 51, 52, 73, e 188 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burg me kusht me kusht me urdhër për mbikqyrje nga shërbimi sprovues në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Ndaj të pandehurit shqiptohet edhe urdhëri për përmbushjen e detyrimit: Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit, detyrim ky në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
3. Gjykata e urdhëron të pandehurin që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Mitrovicë. Shërbimi sprovues e mbikqyrë ekzekutimin e dënimit me kusht me urdhër për mbikqyrje nga shërbimi sprovues si dhe e mbikqyrë edhe urdhërin për përmbushjen e detyrimit sipas pikës 2 të këtij aktgjykimi, dhe për këtë e njoftoj gjykatën.
4. Nëse i pandehuri nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin sipas pikës 2 të këtij Aktgjykimi, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.
5. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguajë shumën prej 20€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30€, dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.38/2021 (2021:0001649), të datës 10.02.2021 kundër të akuzuarit V.P. për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar. 3.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, më datë 23.03.2021, ashtu që në këtë seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se më vjen keq për atë që ka ndodhur, ka ndodhur aty për aty, është e vërtetë që e ka shtyer pak, unë e kam masen e caktuar nga gjykata ndalimin e afrimit për të dëmtuaren-bashkëshorten për 6 (gjashtë) muaj dhe jam duke e respektuar në tërësi, andaj e lus gjykatën që t'i merr parasush të gjitha rrethanat lehtësuese, kushtet ekonomike ngase unë jam duke i paguar tani nga 50 euro si alimentacion për fëmijët, dhe konsideroj se raportet i kemi rregulluar.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par.1 i KPP-së për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në menyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi është bërë pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, prandaj i propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim të

fajësisë ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti i oficerit, i datës 20.12.2020; Raporti mjekësor, i datës 20.12.2020; Deklarata e të dëmtuarës M.V. e dhënë në polici, e datës 20.12.2020; Deklarata e të pandehurit V.P. dhënë në polici, e datës 21.12.2020; Konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.Musa Gashi, datë 22.01.2021. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar. 3.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Si rrethana rënduese është marr fakti se vepra ka ndodhur në raportet familjare e çka sipas ligjit konsiderohet rrethanë ligjore rënduese e paraparë sipas nenit 248 par. 2 të KPRK-së.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, pendimin e thellë premtimin se nuk do të përsërit këtë veprën penale në të ardhmen, faktin se kjo është hera e parë që ka kryer një veprën penale, ngase në bazë të shkresave nuk rezulton se ka vepra tjera, personaliteti dhe kushtet ekonomike, duke pasur parasysh se i njëjtit është duke paguar alimentacion, krejt duke u bazuar në deklarinimin e të akuzuarit.

Gjykata, ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim me kusht, në kuptim të nenit 49 par.1 të KPRK-së, ku është përcaktuar se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryerësit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet. Andaj, në rastin konkret, vepra për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari është e dënueshmë deri në 3 vjet, dhe në këtë rast gjykata ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 muajve, me çka është plotësuar kushti sipas nenit 49 par. 3 të KPRK-së, sipas të cilit, dënimi me kusht mund të shqiptohet kryerësit, nëse gjykata ka shqiptuar dënim me gjobë apo me burgim deri në 2 vjet.

Gjykata, në kuptim të nenit 55 par. 1 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, pasi që konsideron se integrimi i të pandehurit në shoqëri arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit me burgim është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej veprën penale, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së.

Gjithashtu, ndaj të pandehurit, së bashku me dënimin me kusht është shqiptuar edhe urdhëri për përmbushjen e detyrimit: heqja dorë nga përdorimi i alkoolit, në kuptim të nenit 55 par. 2, ku përcaktohet se, kur gjykata shqipton këtë lloj dënimi, ajo mund të urdhëroj edhe një ose më shumë detyrimet e përcaktuara në neni 56 të KPRK-së, e që në rastin konkret ka urdhëruar detyrimin sipas nenit 56 par. 1.8 të KPRK-së. Me rastin e caktimit të këtij detyrimi, gjykata pati parasysh faktin se i akuzuari veprën e ka kryer nën ndikimin e alkoolit dhe se ky ka qene edhe shkak kryesor që ka ndodhur kjo veprë penale, ashtuqë, në rastin konkret, mosmarrëveshjet mes tyre si familje kryesisht e kanë bazën te konsumimi i i alkoolit nga i akuzuari dhe moskontrolli i veprimeve të tij në këto raste, krejt kjo duke pasur për bazë deklarinimin e të akuzaurit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjukata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, dhe atë: në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20€, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumë prej 20 euro, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPP-së. Ndërsa, i akuzuari është obliguar që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumë prej 30€, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv, duke u bazuar në nenin 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 te KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.100/2021, datë 14.04.2021
2021:025453, 14.04.2021

Procesmbajtësja:
Antigona Zahiti

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.